



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
KRYESIA

Nr. 250prot.

Tiranë, më 12.02.2025

Vendim nr. 9, datë 12.02.2025

*Për krijimin e Njesisë së kërkimeve gjeografike*

Referuar nenit 4 pika 6, nenit 13 dhe nenit 19 të Ligjit 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*, mbështetur në nenin 44 të Statutit të Akademisë së Shkencave, pas shqyrtimit të propozimit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (bashkëlidhur nr. 731/1Prot., datë 29.05.2024) lidhur me kërkesën e një grupi studiuesish për themelimin e një njësie të re të përkohshme kërkimore gjeografike pranë ASHSH-së (bashkëlidhur, nr. 731 prot., datë 13.05.2024), si dhe të relacionit shoqërues, Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës   .02.2025,

**Vendosi:**

1. Pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë të krijohet *Njësia e kërkimeve gjeografike*, me qëllim: krijimin e një strukture të qëndrueshme kërkimore që do të drejtojë, koordinojë dhe orientojë studimet gjeografike në vend; ofrimin e mbështetjeve shkencore dhe ekspertize për vendimmarrësit në çështje të menaxhimit territorial, mjedisor, demografik dhe zhvillimor; zhvillimin e projekteve kërkimore me fokus në gjeografinë fizike, sociale, kulturore dhe ekonomike të Shqipërisë; integrimin e studimeve gjeografike në fushën e albanologjisë dhe forcimin e ndërveprimit me disiplinat e tjera shkencore; krijimin e një platforme për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi çështjet gjeografike dhe mjedisore; promovimin dhe mbështetjen e përgatitjeve për studiuesit e rinj; forcimin e bashkëpunimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar;
2. Platforma e paraqitur nga grupi nismëtar për qëllimin, objektivat dhe përparësitë e njësisë (bashkëngjitur) të vlerësohet si dokument bazë për programin dhe veprimtarinë e njësisë;
3. Kjo njësi e përkohshme kërkimore shkencore mbi gjeografinë të njihet me emrin *Njësia e kërkimeve gjeografike*;

4. Njësia të përbëhet nga bordi nismëtar i saj: prof. dr. Perikli Qirjazi, prof. dr. Dhimitër Doka, prof. dr. Skënder Sala, prof. dr. Bilal Draçi, prof. as. dr. Merita Koka, prof. as. dr. Jostina Dhimitri dhe me drejtues prof. Perikli Qirjazin;
5. Kohëzgjatja e veprimtarisë së saj është 2 vjet;
6. Brenda muajit maj 2025 njësia kërkimore gjeografike të hartojë rregulloren e saj të brendshme. Deri më 30 mars 2025, njësia të zhvillojë mbledhjen e saj të parë.
7. Akademia e Shkencave siguron mbështetjen logjistike dhe mbulon sipas mundësive të saj shpenzimet financiare për veprimtarinë e *Njesisë së kërkimeve gjeografike* në përputhje me statusin e njësive të kërkim-studimit;
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: kryetari i SSHSHA-së, sekretari shkencor, bordi drejtues i *Njesisë së kërkimeve gjeografike* dhe kancelari;
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Akad. Skënder G.JINUSHI**

